



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Procesverbal

i mbledhjes së trupës gjyqesore nr. 03

I mbajtur sot më datë 25.06.2018 për mbledhjen e zhvilluar nga trupa gjyqesore nr. 03 për shqyrtimin e ankimit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit z. Fatmir Hoxha.

Të pranishëm në mbledhje janë anëtarët e trupës gjyqesore nr. 03, komisionere Xhensila Pine në cilësinë e kryesueses, dhe komisionere Valbona Sanxhaktari në cilësinë e anëtares. Për arsye shëndetësore, komisionere Alma Faskaj që ka cilësinë e kryesueses së kësaj trupe, është në pamudësi të jetë prezent në këtë mbledhje.

Trupa asistohet nga sekretare gjyqësore Ina Serjanaj.

**Komisionere Xhensila Pine:** Në datë 25.06.2018 pranë zyrës së protokollit të KPK-së është paraqitur ankimi ndaj vendimit nr. 18 datë 10.05.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, ankim i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit z. Fatmir Hoxha, i cili mban nr. 4868 Prot.

Bazuar në nenet 45, 46 dhe 48 të ligjit nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", si dhe nenit 63 të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", çmuj se ky ankim përmban elementët ligjorë, dhe për këtë arsye duhet të pranohet.

**Komisionere Valbona Sanxhaktari:** Dakort.

**Komisionere Xhensila Pine:** Për sa më sipër, trupa gjyqesore në përfundim të kësaj mbledhje vendosi:

- Të pranohet ankimi e protokolluar pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit në datë 25.06.2018, me nr. 4868 Prot., i paraqitur nga ankimesi z. Fatmir Hoxha subjekt rivlerësimi, përfaqësuar nga av. Julian Mertiri, dhe të dërgohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit sipas ligjit.

Tiranë më 25.06.2018.

Sekretare Gjyqësore  
Ina Serjanaj

Vëntetohet se:  
Aktet janë dorëzuar  
në zyrën e sekretarit  
për shqyrtimin e ankimit  
në datën 25.06.2018.  
30.06.2018.